



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
Uprava za Urbanizam, Planiranje i Zastita Okoline
Department for Urbanism, Planning and Environmental Protection
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Opština Orahovac - Opština Uprava

Nr. Lprot 1283 Më 26.04.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

DATE/A	26.04.2019
PËR/ZA/TO	z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
CC	
NGA/OD/FROM	z. Rumir Zhuniq, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
LËNDA/PREDMET/SUBJEKT	Raporti Janar – Mars 2019



Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në tre mujorin e parë të vitit 2019 janë kryer këto punë dhe aktivitete sipas planit-vjetor të punës së qeverisë komunale në Rahovec:

Kërkesat e qytetarëve të drejtuara në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, janë shqyrtuar në afatin ligjor.

Kërkesat e qytetarëve në tre mujorin e parë të vitit 2019 ishin këto, Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore, Leje Rrërimi, Leje Mjedisore Komunale, Pëlqime, Vërtetime Urbanistike, Njoftime, etj.

Projektet Kapitale

Në fillim të janarit është shpallur tenderi, sipas planit të prokurimit, dhe është lidhur kontrata për hartimin e projekteve të ndryshme në Komunën e Rahovecit. Janë hartuar projektet: Ndërtimi i SHFMU "Liria" në Fortesë, Terrenet Sportive në Komunën e Rahovecit, Projektet për asfaltimin e dy rrugëve, rruga Rahovec-Baboc-Fortese si dhe Rruga Xerxe-Sapniq-Ratkoc, dhe ka filluar të hartohet edhe projekti për rregullimin dhe trajtimin e shtratit të lumit që fillon nga Hoqa e Madhe e që vazhdon në Brestoc, Hoqë e Vogël, Nagac dhe përfundon në Krushë të Madhe.

Është shpallur konkursi i projektimit për hartimin e projektit ideor për kompleksin muzeal të Ukshin Hotit në Krushë të Madhe.

Është shpallur tenderi për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, po ashtu sipas planit të prokurimit dhe planit të punës për vitin 2019 dhe shumë shpejtë pritet të lidhet edhe kontrata për të vazhduar me punë tjera rreth procesit të hartimit së bashku me kompaninë konsulente.

Këtë fillim vit, kemi përcaktuar lokacionin në të cilën synojmë të projektojmë sheshin qendror të qytetit të Rahovecit. Për ta bërë një planifikim sa me efektiv dhe të qëndrueshëm, ne kemi ndërmarr të gjitha aktivitetet që gjendja e terrenit ku planifikojmë të ndërtojmë sheshin të jetë sa më e qartë. Kemi kërkuar nga KRU "Gjakova" dhe KEDS-i informatat për rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit dhe elektrikes në këtë pjesë. Gjithashtu mbështetje profesionale për hartimin e projektit kemi gjetur edhe të organizata për planifikim urban, UN-Habitat. Pjesa që do të përfshihet në trajtimin e projektit të sheshit është vendi të Stadiumi i Qytetit, Tregu i Qytetit, Parku i Qytetit, pjesa ku ka qenë Eko-Regjioni dhe hapësirat tjera komunale përreth.

Mbikëqyra e punimeve është duke vazhduar, secili projekt mbikëqyret dhe bëhet raport javor nga mbikëqyrësi dhe e pranojmë atë raport në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Punët në projektet kapitale kane rifilluar edhe këtë vit, ka vazhduar punët kompania për krijimin e hapësirave të gjelbëruara, është përfunduar rregullimi i parkut në fshatin Gexhë, oborri i shkollës fillore në Senoc dhe vendosja e ulëseve në parkun e qytetit në Rahovec, në fshatin Xërxë dhe Fortesë.

Projekti i trajtimit të lumit ndërmjet dy fshatrave, Krushë e Madhe dhe Celinë ka rifilluar me pune edhe në tre mujorin e vitit 2019. Po ashtu edhe në Kompleksin e Dëshmorëve në Gradish. Renovimi dhe fasadimi i objektit të banimit kolektiv në rrugën Xhelal Hajda-Toni ka vazhduar, dhe shpejtë pritet që ky projekt i nisur në fund të vitit 2018 të përmbyllet në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019.

Kemi formuar komision për pranim teknik të projektit për rregullimin e shtratit të lumit në fshatin Zoqisht, jemi në pritje të raportit të komisionit.

Mjedisi

Me 22 mars, në ditën botërore të ujit, bashkë me nxënës dhe arsimtarë të disa shkollave të komunës së Rahovecit, kemi vizituar burimin e Drinit të Bardhe, për të shënuar këtë ditë në kuadër të kalendarit për ditët botërore që lidhen me mjedis.

Zyrtarja për mjedis, se bashku me GIZ-in gjerman kane vazhduar punën për identifikimin e deponive ilegale në komunën e Rahovecit dhe është bërë raporti për të gjitha depotinë që gjenden në komunën e Rahovecit.